



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

4-POLIS  
NR. 67/16, PROT.  
DT. 24.05.2016

Nr. 5240 Prot.

Tiranë, më 20.05.2016

**URDHËR**

Nr. 269, datë 20/05/2016

**“PËR  
AKREDITIMIN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË,  
“MASTER PROFESIONAL” NË “ADMINISTRIM BIZNESI” ME PROFILE  
“SIPËRMARRJE DHE INOVACION”, “PASURITË E PALUAJTSHME”,  
“MARKETING DHE STRATEGJI”, NDËRMJET UNIVERSITETIT “POLIS” DHE  
IPAG BUSINESS SCHOOL, PARIS, FRANCË”**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 138 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit nr. 424, datë 28.4.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Akreditimin e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Administrim Biznesi”, me profile “Sipërmarrje dhe Inovacion”, “Pasuritë e Paluajtshme” dhe “Marketing dhe Strategji”, të Fakultetit “Planifikim, Mjedis dhe Menaxhimi Urban” të Universitetit “Polis”, ndërmjet Universitetit “Polis” dhe “IPAG Business School”, Paris, Francë, që realizohet me 90 kredite, me formë studimi me kohë të zgjatur, me kohëzgjatje 2 vite akademike/4 semestra, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master Profesional” në “Administrim Biznesi”, me profile “Sipërmarrje dhe Inovacion”, “Pasuritë e Paluajtshme” dhe “Marketing dhe Strategji”.
2. Ky program studimi akreditohet në bazë të Vendimit nr. 123, datë 18.02.2016, të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror për Arsimin dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për kontrollin periodik të ligjshmërisë.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Universiteti “Polis”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

